Ndërsa cilësia dhe karakteristikat kryesore të tokës në zonën e Çiflikut janë të përfaqësuara si më poshtë. Bujqësia në këtë zonë është intensive dhe dominohet kryesisht nga drithërat dhe foragjeret. Më shumë se 90% e sipërfaqes së tokës është e punueshme e cila ujitet, fertilizohet dhe punohet me makineri me një shkallë të lartë të intensiteti të prodhimit. Të mbjellat kryesore përfaqësohen nga drithërat, si misri dhe gruri, me 60% dhe foragjeret, jonxha, me 40%. Origjina e materialit nënë është e llojit aluvialen të "pakonsoliduar". Teksitura është argjillore dhe silt, pa prani gurësh në sipërfaqe (<10%), e thellë (> 75 cm), me sipërfaqe të sheshtë (pjerrësia e shpatit <6%), me një shkallë të ulët erozioni dhe drenazhim të mirë me tuba qeramike. Në sipërfaqe ka të çara dhe lloji i tokës është Eutric Luvisol, i cili është klasifikuar, gjithashtu, si pjesë e klasës së II-të.

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

5.2 Përshkrimi i Mjedisit Biologjik

Karakteristika biologjike dhe ekologjike

Zona e projektit kalon nëpër një shumëllojshmëri habitatesh, ku dominohet nga përdorimi i tokës me modelet komplekse bujqësor të kultivimit dhe toka pjellore të pa ujitura (pa kultivuar), që shtrihen nga fshati Turan deri në fshatin Pendavij. Ndërsa fshati Zemblak karakterizohet nga toka të ujitura në mënyrë të përhershme dhe nga prania e lumit të Devollit, i cili është një habitat i mundshëm i lundrës.

Flora

Kanalet e kullimit, pyje breglumore dhe kullotat gjysmë-natyrore, janë të dominuar nga *Populus nigra*, *Salix alba*, *Populus canadensis*, *Bromus erectus*, *Alopecurus pratensis*, *Arrhenatherum elatius*, *Poa trivialis*, *Tragopogon pratensis*, *Leucanthemum vulgare*, *Campanula patula* dhe *Sambucus ebulus*. Kulturat më të rëndësishme që kultivohen në këto zona janë gruri, misri, fasulja, elbi dhe jonxha.

Në zonën e Korçës ndodhen të mbjellura mbi 30 bimë mjekësore dhe aromatike, ku mund të përmendim *Ceterach officinarum*, Karotë e egër (*Daucus carota*), Dëllinjë e zezë (*Juniperus communis*) dhe Dëllinjë e kuqe (*Juniperus oxycedrus*).

Ekologjia e zonës karakterizohet nga prania e lumit të Devollit, me një shtrat të gjerë dhe rripi breglumore të ngushtë në të dyja anët e tij. Habitatat natyror të lumit është ndryshuar për shkak të aktiviteteve të shfrytëzimit minerar të lumit, të cilat kanë sjell si rezultat ndryshimin e rrjedhës së ujit dhe krijimin e pishinave dhe pellgjeve. Bimësia breglumore është e dominuar nga Shelgu i bardhë (*Salix alba*) dhe Pisha e Zezë (*Pinus nigra*). Midis bimësisë ujore, janë vëzhguar në trupin ujorë specie si *Cladophora glomerata*, *Chara gymnophylla*, *Potamogeton crispus*, *Potamogeton fluitans*, dhe në pellgje, algat e gjelbëra filamentoze.

Diversiteti i bimëve ujore në këtë pjesë të lumit është relativisht e lartë, me 19 specie të regjistruara. Kryesisht dominohen nga specie makrofitesh të zhytura dhe emergjente, të cilat janë të përqendruara në zonat moçalore dhe ku rrjedha e ujit është e ngadaltë. Llojet më të bollshme që hasen janë algat e gjelbëra *C. glomerata* me një shkallë mbulesë prej 4%.

Edhe diversiteti i komunitetit benthik është gjithashtu i lartë, me 83 specie të regjistruara. Megjithatë, vlera e Indeksit Trofik të Diatomeve ishte i lartë, gjë që tregon habitate eutrofike, pra cilësi të dobët të ujit. Megjithatë, pavarësisht këtij treguesi, janë identifikuar 13 lloje diatomesh në mostrat e marrë, të cilat janë pjesë e Listës së Kuqe Evropiane për diatometë, gjë e cila është një tregues i habitateve të rralla ose të rrezikuara.

Karakteristika e faunës

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Siç u përmend më sipër, në luginën e Korçës janë të shpërndara shumë gjerësisht zonat bujqësore. Ato përbëhen nga tokave bujqësore dhe toka të punueshme të braktisura, të cilat janë shndërruar në kullota, të vendosura në afërsi të vendbanimeve (fshatrave). Habitati mbështet nga një bollëk të lartë të llojeve të shpendëve, kryesisht të Rendit të Passeriformes. Në dimër fushat e hapura përdoren nga tufat e harabelave, nën shoqërinë e Passeriformes të vogël. Ndërsa në verë, fushat e hapura janë baza për shumimin e thëllëzave.

Pemët frutore të terrenit vizitohen nga gushëkuqat, harabelat, pupëzat dhe pëllumbat. Llojet më karakteristike të gjitarëve janë Miu i shtëpise (*Mus musculus Domesticus*), Miu i pyllit (*Apodemus sylvaticus*) dhe Miu i Ondriasit (*Microtus epiroticus*). Gjithashtu, plantacionet me pemë frutore janë të përhapur edhe pranë zonës së Cangonji-Zemblak. Edhe pse të themeluar relativisht vonë (10-15 vitet e fundit), ky lloj habitati është ende në zgjerim, meqenëse fermerët janë të interesuar në zhvillimin e mëtejshëm të hortikulturës në fushat e Devollit dhe të Korçës. Plantacionet e pemëve frutore të mollës, kumbullës dhe qershis ofrojnë disa niche ekologjike për zvarranikët (do me thënë hardhuca të tilla si ajo e Gjelbër Evropiane dhe hardhuca e murit, Passeriformes të ndryshme, bee-eater, pupëza. Shumica e llojeve të gjitarëve të zakonshme janë dhelpra (*Vulpes vulpes*), Baldosa (*Meles meles*), Nuselalja (*Mustela nivalis*), urithi dhe miu. Zogjt grabitqarë, të till si skifterit kthetrazi shpesh herë vërehen në gjueti mbi plantacionet e pemëve frutore. Githashtu janë gjetur eskremente të ujkut (*Canis lupus*) në kullotat me bagëti të vogëla. Nënshtrësia e poshtme të lumit përbëhet nga sedimente me guralecë, të cilat ishin pjesërisht të mbuluar nga makrovegetacion, duke krijuar një habitat tërheqës për ndërvetebrore bentik.

Duhet të theksohet se prania e aktiviteteve minerare dhe depozitimin e mbetjeve (si inerte dhe urbane) ka të ngjarë të ketë pasur ndikim në komunitetin bentik të kësaj zone.

Janë regjistruar dhe pesë lloje peshqish, të cilët janë Peshku i gurit gjarperues (*Cobitis ohridana*), Petulica e Devollit (*Alburnoides Devolli*), Skobusi (*Chondrostoma nasus*), Kleni (*Squalius cephalus*) dhe Mrena e Prespes/mustaku (*Barbus prespensis*). Nga të pestë, të gjithë janë të kategorizuar si të mbrojtura në nivel kombëtar, përveç *S. cephalus*. Në kontekstin evropian, vetëm Mrena e Prespes (*B. prespensis*) është e shënuar nën Shtojcën II dhe V të Direktivës së Habitave të BE-së.

Zonat e rrjetit ekologjik kombëtar

Zona e studimit përfshihet në një territor me karakter të urbanizuar, me prani infrastrukturash, të cila ndërlidhet me modele komplekse bujqësore dhe kultivimi. Kështu që nuk do të ketë ndikim në Zonat e Mbrojtura.




Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, Ish Digitalb
Tirana/Albania

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces





Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, Ish Digitalb
Tirana/Albania

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Figura 3: Afërsia me zonën e mbrojtur të biotopit (ERM 2010)

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

5.3 Karakteristikat klimatike

Zona e studimit i takon klimës së nën-zonës Jugore Mesdhetare Para-malore. Sipas të dhënave në dispozicion, vërehet se temperaturat e ajrit janë më të ftohtat e Shqipërisë, ku ka një ndikim të rëndësishëm kontinental. Temperatura mesatare vjetore në Korçë është 10.5°C, me temperaturë mesatare prej 20°C në korrik dhe në 0.5°C në janar. Korça regjistron temperaturat më të ulëta në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë për shkak të depërtimit të masave të ftohta ajrore.

Tabela 1: Temperatura mesatare mujore e ajrit (°C) (1951 – 1990)

Stacioni	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Mesatare vjetore
Korça	0.5	2.2	4.9	9.2	13.9	17.6	20	20.2	16.5	11.3	6.8	2.5	10.5

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH)

Tabela 2: Temperatura minimale absolute e ajrit (°C) (1951 – 1990)

Stacioni	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Mesatare vjetore
Korça	-20.9	-17.3	-16.5	-10.5	0	2.6	4.9	6.6	-0.5	-7.5	-10.2	-19	-20.9

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH)

Tabela 3: Temperatura maksimale absolute e ajrit (°C) (1951 – 1990)

Stacioni	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Mesatare vjetore
Korça	17.4	21.8	26.3	26.7	31.6	34.3	38.7	36.5	33.1	27.6	25	18.1	38.7

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH)

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Tabela 4: Numri i ditëve me Temperatura $\leq 0^{\circ}\text{C}$ (1951 – 1990)

Stacioni	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Mesatare vjetore
Korça	23.8	17.0	14.0	2.6	-	-	-	-	0.1	1.7	7.6	21.1	87.9

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH)

Sipas të dhënave të reshjeve, zona përmban reshje të ulëta në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Ekziston edhe një shpërndarje e parregullt gjeografike e reshjeve vjetore. Në verë ato përfaqësojnë vetëm 12.5% të reshjeve vjetore, si rezultat i një ndikimi kontinentale mbi klimën. Dëborat më së shpeshti ndodh nga nëntori në Prill.

Tabela 5 Reshjet mujore dhe sezonale(mm) (1951 - 1990)

Stacioni	Muaj											
	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Korçë	78	73	59	60	74	43	32	31	48	85	109	98
Stacioni	Sezoni									Totali (Vjetor)		
	Dimër		Pranver		Ver		Vjesht					
Korçë	249		193		106		242		790			

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH)

Tabela 6 Numri i ditëve me reshje (1951 - 1990)

Stacioni	Numri i ditëve		
	Reshje $\geq 0.1\text{mm}$	Reshje $\geq 1\text{mm}$	Reshje $\geq 10\text{mm}$
Korca	130.7	94.1	25.8

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH)

Tabela 7 Numri i ditëve me dëborë (1951 - 1990)


Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Stacioni	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Totali (Vjetor)
Korca	12.3	11.4	3.8	5.3	-	-	-	-	-	-	0.7	6.3	34.8

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH)

Era



Source: Institute of Hydrometeorology of Albania (IHMA)

Figura 4: Trëndafili i Erës për Sheqeras (Instituti Hidrometeorologjik Shqipëtar (IHMSH))

Sipas këtyre të dhënave, në Korçë dominojnë erërat nga VP dhe L. Shpejtësia mesatare e erës të regjistruara në stacionin e meteorologjik të Sheqeras (12 km largësi ajrore nga zona e studimit) janë midis 2.1 dhe 5.6 m / s, brenda intervaleve të treguara në hartat e erës.

5.4 Përshkrimi i Mjedisit Socio-Ekonomik

Popullsia

Qyteti i Korçës gjendet në jugperëndim të Shqipërisë dhe ka një popullsi prej 105,000 banorësh. Qyteti ka një universitet, i specializuar në shkencat sociale, biznesit dhe shkencës. Korca është një qytet i rëndësishëm si për Kishën Ortodokse ashtu edhe për Myslimanët Sunitë, pasi është selia e peshkopit metropolitan Ortodoks dhe vendi i xhamisë

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces


më të vjetër në Shqipëri. Zona përreth është e njohur për prodhimin bujqësor dhe është zona kryesore e rritjes së grurit në Shqipëri.

Shpërndarja e popullsisë në zonën përreth gjurmës së projektit (sipas njësive administrative):

Njësi administrative ose fshat	Bashkia	Popullsia (regjistruar në 2008)
Pojan	Korçë	17600
Qendër	Korçë	13766
Drenovë	Korçë	10962
Korçë	Korçë	34825
Progër	Korçë	6280

Profili ekonomik

Gama e aktiviteteve bujqësore raportohet kryesisht në zonën e studimit. Fermat dhe aktivitetet e nënprodukteve të qumështit është një aktivitet kyç ekonomik në zonën e studimit dhe ka të paktën 1 fabrikë qumështi në çdo ish-komunë (njësi administrative). Qumështi ose shitet direkt në qumështore për përpunim dhe prodhim të djathit ose shitet derë më derë nga fermerët individualë. Banorët raportojnë se shumica e familjeve mbajnë së paku 1 lopë dhe disa dele për konsum personal, edhe nëse nuk janë të varur nga blegtoia për qëllime ekonomike.



Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Gruri është gjithashtu një kulturë e rritur nga shumica e familjeve ose për shitje ose për përdorim në shtëpi për të bërë bukë, së bashku me misërin, i cila përdoret si ushqim për kafshët. Përveç prodhimeve kryesore bujqësore që gjenden në të gjithë zonën e studimit, ekzistojnë fusha specifike përgjatë gjurmës së projektit që specializohen në prodhime të caktuara. Kjo përfshin prodhimin e mollës dhe frutave të pyllit në rrethin e Korçës dhe Devollit;

Përdorimi i përgjithshëm i tokave bujqësore brenda zonës së studimit, duke lejuar identifikimin e zonave të kulturave të përhershme dhe përdorimit të përzier të tokës bujqësore në nivelin e vendbanimit. Disa nga këto zona, kryesisht të përqendruara në rrethin e Devollit, janë identifikuar si me ndjeshmëri kyçe për projektin për shkak të produktivitetit dhe shqetësimeve të larta.

Çdo vendbanim i anketuar në zonën e studimit ka të paktën një dyqan kafeje dhe një dyqan ushqimor për produktet vendase dhe ushqime të paketuara. Numri i dyqaneve rritet proporcionalisht me madhësinë e popullsisë.

Aktivitetet industriale dhe komerciale në zonën e studimit janë aktualisht në një shkallë të vogël me drejtim familjar ose në shkallë të mesme në zonat urbane dhe në periferi të tyre. Aktivitetet kryesisht përfshijnë fabrikat e përpunimit të ushqimit, fabrikat e tekstilit, bizneset e ndërtimit etj.

Përdorimi i tokës

Në zonën e Korçës, kulturat mbizotëruese sezonale janë të ndërthurura me zona të kulturave të përhershme (pemë molle). Vendbanimet e Turan-Ravonik (Komuna Drenovë) dhe Bulgarec-Ciflik janë rurale, por rriten me shpejtësi në zonat gjysmë urbane. Rrugën Korça - Pogradec kalon në jug të Ciflik dhe Bulgarec. Shumë biznese të vogla të vendosura përgjatë rrugës. Një zonë urbane është caktuar nga të dyja anët e rrugës dhe është fokusi për zhvillimin urban në nivelin rajonal. Plantacionet e mollës me intensitet të lartë rrethojnë vendbanimin e Zëmlakut (Komuna Pojan) dhe në perëndim vendbanimet e Mollaj (Komuna Mollaj).

Në Devolli identifikohen kultura të përziera sezonale dhe të përhershme. Kur rrethi takon Korçën (Komuna Proger) toka është pyjore malore dhe të mbjella të përhershme (mollë) në luginë. Rreth vendbanimeve takohet përdorimi i tokës gjysmë urbane (Vishocicë, Kuç dhe Vranisht).



Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, Ish Digitalb
Tirana/Albania


email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces





Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, Ish Digitalb
Tirana/Albania

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Figura 5: Përdorimi i tokës në gjurmën e projektit (burimi ERM 2010)

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Pronësia mbi tokën dhe fragmentimi i saj

Gjatë epokës komuniste, të gjithë tokat ishin në pronësi kolektive nga shteti. Në vitin 1991 u zbatua ligji i ri (Ligji 7501/1991 mbi Tokën), që ka çuar në një reformë të plotë të sistemit të mbajtjes. Disa çështje të rëndësishme të tokës mbeten të hapura dhe krijojnë paqartësi dhe pengesa në sistemin e mbajtjes së tokës dhe transaksioneve. Mosmarrëveshjet mbi çështjet e tokës dhe pronësisë mbi të mund të pengojnë procesin e identifikimit, vlerësimit dhe kompseimit të tokës, sidomos parcelat private. Ky kontekst i tranzicionit po krijon një numër të madh mosmarrëveshjesh, me të cilat sistemi gjyqësor i vendit po përpiqet ti “përballojë”. Regjistrimi i të drejtave të pronësisë mbetet ende një çështje e pazgjidhur dhe si pasojë e çështjeve të sipërpërmendura, regjistrat kadastralë janë jo të plotë.

Çështja e kthimit / kompensimit të të drejtave të pronësisë është ende e pazgjidhur. Kthimi i tokës bujqësore është debatuar që nga viti 1993, kur ligji origjinal 7698 për kthimin e pronës tek pronarët e ka përjashtuar këtë kategori. Zbatimi i këtij ligji ende vazhdon të jetë jo i plotë.

Shpërndarja relativisht e barabartë e tokës bujqësore në familjet rurale në vitet 1990 ka rezultuar në një fragmentim ekstrem të pronësisë mbi tokën. Numri i madh i pronarëve të tokave komplikon zhvillimet në vendimmarrje, si dhe shfrytëzimin bujqësor në shkallë të gjerë të tokës. Disa parcela të tokës janë me cilësi të dobët për qëllime bujqësore dhe familjet që kanë emigruar kanë braktisur të tjera.

Ndërtimet pa leje: Gjatë viteve 1990 shumë parcela u ndanë dhe u ndërtuan strukturat/ banesa në toka pa autorizim ligjor (leje ndërtimi). Këto veprime rezultuan në krijimin e zonave joformale urbane në periferi të qyteteve, në zonat e përqëndruara të hoteleve dhe shërbimeve turistike, në ndërtesat e tregtisë dhe të shërbimit të shpërndara në autostrada dhe në shtëpi bujqësore jashtë qendrave të fshatit. Të tilla parcela të paaautorizuara të tokës dhe ndërtimet e paligjshme tani përbëjnë një pjesë të madhe të të gjitha pronave të paluajtshme.

Remitancat dhe ndihma ekonomike

Të ardhurat nga dërgesat e emigrantëve kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në ekonominë shqiptare që nga vitet 1990. Në vitin 2007, në Shqipëri u dërguan mbi 1 bilion dollarë remitancash, që përfaqëson 15% të PBB1-së. Remitancat në Shqipëri janë tri herë më të larta sesa investimet e drejtpërdrejta neto të huaj dhe pothuajse dyfishi i ndihmës zyrtare për zhvillim të marrë nga Shqipëria. Një pjesë e madhe e emigrantëve (68,6%) dërgojnë remitancat në Shqipëri me 90% të këtyre remitancave hyrëse me origjinë nga vendet evropiane (UNDP, 2009).

¹ Hoti. E. (2009) Remitancat dhe varfëria në Shqipëri. Departamenti i Ekonomisë në Universitetin e Lundit

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Përdorimi i energjisë

Prodhimi i energjisë në Shqipëri dominohet nga termocentralet hidroelektrike, të cilat llogarisin gjysmën e konsumit të energjisë në Shqipëri. Pavarësisht nga prodhimi i hidrocentraleve në Shqipëri, brenda zonës së studimit, familjet raportuan se përdorin drurin, energjinë elektrike dhe gazin si burimi kryesor të energjisë në familje. Shumica e familjeve në rajonin e Korçës përdorin drurin si burim kryesor të ngrohjes dhe gatimit, ndërsa 82% e banorëve të Devollit përdorin gazin në bombula për gatim.

Vlerat e mbrojtura naturalistike dhe socio-kulturore

Rajoni i Korçës përfaqëson një territor me zhvillime intensive kulturore që janë shumë domethënëse dhe përfaqësuese për karrierën njerëzore në pjesën tjetër të Evropës Juglindore. Kohët e fundit, dëshmitë më të hershme për veprimtarinë njerëzore janë të datuara nga Paleolitik i Sipërm, pas gjetjeve sipërfaqësore të traditës së Paleolitit të Sipërm në afërsi të fshatit të vjetër të Kamenicës (Gjipali 2006). Procesi i rëndësishëm neolitizimit i fundit të Mijëvjeçarit të 7 p.e.s. është përfaqësuar me zonat e hershme neolitike të Podgorit, Vashtëmit, Progërit, por edhe Sovjanit, siç tregohet nga gërmimet e fundit të ekipit franko-shqiptar dhe të botuar në disa raste (Lera, Prendi, Touchais 1994). Pjesa tjetër e neolitit është e përfaqësuar mirë në rajonin e Korçës në vendbanime të tilla si Dunavec, Burimas, Dersnik, por edhe Maliq, Sovjan, Tren dhe Kamnik (më tutje në jug, në rajonin e Kolonjës). Maliq ka origjinën nga parahistoria e vonë e Shqipërisë.

Fillimi i Epokës së Metaleve (bakër dhe bronz) është i përfaqësuar gjerësisht në vende të tilla si Maliq, Sovjan, Tren (Korkuti 1971). Vende të hapura, shpella, banesa në shtylla druri në brigjet e liqenit dhe majat e kodrave janë llojet kryesore të vendbanimeve të identifikuar.

Shpërndarja e tyre në rajon ndjek një model të mire konsoliduar: afër liqeneve, afër zonave me potencial të lartë bujqësor dhe në afërsi të zonave me biodiversitet të zhvilluar, të cilat në mënyrë tipike mbështesin një aktivitet ekonomik të larmishëm. Gjatë shekullit VI p.e.s., në pellgun e Korçës janë zbuluar disa tumula në Barç (Andrea 1985), Kuç i Zi (Andrea 1985), Kamenicë (Bejko 2004, 2006), por shumë më tepër janë identifikuar dhe regjistruar si të dëmtuar ose me tiparet arkeologjike pothuajse tërësisht të fshira.

Periudha e vonshme romake, në vend të kësaj, duket më e përfaqësuar në zonën e Korçës në Polenë, Rëmbec, Trajan, së bashku me prova të rëndësishme për okupimin në Mesjetë. Vezhgitet sipërfaqësore zbulojnë shumë më tepër material arkeologjik në zonë për periudhën otomane dhe Moderne të hershme. Modeli i okupimit njerëzor që shfaqet është ai që fokusohet në disa periudha të veçanta historike: epoka neolitike, epoka e bronzit / hekurit dhe mesjetare / moderne e hershme.

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

6. Ndikimet Socio-Ekonomike

Analiza e mëposhtme e ndikimeve socio-ekonomike ka të bëjë me fazën e ndërtimit dhe të operimit. Ndikimet janë të ndara, në ato negative dhe ato pozitive. Përveç kësaj, duhet të merret parasysh kohëzgjatja e ndikimit, veçanërisht në lidhje me përdorimin e tokës.

Për shkak të fazës së zhvillimit të projektit, ka një numër të aspekteve të projektit ende për t'u përcaktuar që ndikojnë në madhësinë e ndikimeve për ekonominë dhe punësimin. Keto përfshijnë:

- Madhësinë e disa komponentëve të fuqisë punëtore ndërtimore, veçanërisht gjatë fazës së ndërtimit;
- Punëtorët e pakualifikuar dhe gjysëm të kualifikuar si përqindje e fuqisë punëtore të përgjithshme; dhe
- Rezultatet e analizës së zinxhirit të furnizimit të projektit.

Seksionet e mëposhtme diskutojnë ndikimet ekonomike dhe të punësimin në lidhje me ndërtimin, operimin dhe dekomisionimin e projektit.

Përderisa në këtë fazë nuk është e mundur të parashikohen përfitimet aktuale ekonomike në terma monetarë, një tregues i rendit të madhësisë potenciale të mundësisë ekonomike mund të rrjedh nga krahasimi me projekte të ngjashme.

6.1 Ndikimet pozitive

Gjatë fazës së ndërtimit, projekti parashikon mundësi të përkohshme punësimi, në mënyrë direkte dhe indirekte (kryesisht të pakualifikuar). Gjatë fazës së funksionimit do të kërkohej punësim afatgjatë në pozicionet e mirëmbajtjes, monitorimit dhe sigurisë.

Ndikimet ekonomike dhe të punësimin nga projekti mund të pritet të rriten gjatë fazave të ndërtimit dhe të operimit. Është gjatë kësaj periudhe që Projekti do të duhet të punësojë punëtorë dhe të blejë mallra dhe shërbime, që rezultojnë, potencialisht, në impakt pozitiv në ekonominë lokale. Punësimi i përkohshëm gjatë fazës së ndërtimit përfshin personat e punësuar drejtpërsëdrejti për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e impiantit, si dhe funksionimin e tij dhe komponentëve të tjerë të projektit. Ajo gjithashtu përfshin punë që furnizojnë mallrat dhe shërbimet e nevojshme për të mbështetur procesin e ndërtimit, duke përfshirë shërbimet e ushqimit dhe transportit dhe personelin mbështetës në kampin e ndërtimit.

Aktivitetet e ndërtimit do të kërkojnë një numër të konsiderueshëm punëtorësh lokalë të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Megjithatë, parashikohet një ndikim pozitiv në jetesën lokale gjatë fazës së ndërtimit përmes krijimit të mundësive të reja të punësimin. Përveç kësaj, do të përfitojnë edhe furnizuesit vendorë, pasi që do të kontraktohen për furnizimin me ujë,

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

ushqime etj. Duke marrë parasysh sa më sipër, parashikohen përfitime të dobishme nga projekti i propozuar për punësimin dhe ekonominë lokale. Ndërtimi i projektit do të shtojë mundësi të përkohshme pune për punëtorët teknikë dhe jo teknikë. Ndërtimi i projektit ofron vende të lira pune të përkohshme gjatë periudhës së ndërtimit. Prandaj, ndikimi i krijimit të vendeve të punës është klasifikuar si i rëndësishëm.

Në nivel kombëtar, sektori i ndërtimit është një aktivitet ekonomik relativisht i rëndësishëm, duke kontribuar në rreth 13% të PBB-së. Prandaj, ka të ngjarë që kandidatët me përvojë do të jenë në dispozicion në nivel kombëtar për të plotësuar disa nga punët e kualifikuara në projekt. Duke pasur parasysh përvojën teknike specifike të kërkuar për ndërtimin dhe funksionimin e impiantit dhe natyrën globale të industrisë, pritet që numri i vendeve të kualifikuara për ndërtimin e tubacionit nga shtetasit shqiptarë do të jetë relativisht i kufizuar.

Në përgjithësi, duke pasur parasysh afatin e shkurtër për fazën e ndërtimit, mundësi do të jenë të kufizuar për punëtorët e pakualifikuar që të zhvillojnë aftësi të tjera në punë. Përkundrazi, do të ketë më shumë punë për punëtorët e përhershëm gjatë fazës së operimit, pritet që do të ketë më shumë mundësi për trajnimin dhe mësimin në vendin e punës për fuqinë punëtore në këto komponente.

Ndikimet e drejtpërdrejta do të përfshijnë krijimin e vendeve të reja të punës për punonjësit e operimit dhe të mirëmbajtjes dhe të ardhurat dhe tatimet e lidhura me të cilat i paguhet shtetit. Numri i përgjithshëm i mundësive të punës të përhershme, që do të sigurohet nga projekti gjatë fazës së operimit, është 123 punonjës.

Do të ketë edhe kërkesa shtesë për shërbime, si p.sh. transportimi dhe furnizimi i ushqimit në zonën e projektit. Blerja e mallrave dhe shërbimeve gjatë ndërtimit do të gjenerojë gjithashtu një numër të punësuarish lokal, kryesisht nga qytetit i Korçës dhe nga vendbanimet afër zonës së planifikuar për ndërtim. Ndikimet ekonomike gjatë ndërtimit do të rrjedhin nga prokurimi i mallrave dhe shërbimeve (duke përfshirë materialet e ndërtimit, punësimin lokal dhe efektet ekonomike të nxitura nga shpenzimet dhe nga punëtorët e ndërtimit). Informacione të hollësishme për nevojat e prokurimit në fazën e ndërtimit ende nuk janë në dispozicion në këtë fazë. Kushtet e përgjithshme, llojet e mallrave dhe shërbimet e kërkuara ndër të tjera përfshijnë:

- Transport, furnizim ushqimi, lavanderi, furnizim ushqimi, shërbime sigurie për kamp;
- Furnizimi me automjete dhe pajisje ndërtimi; dhe
- Sigurimi i materialeve ndërtimore duke përfshirë agregate / rëra, beton dhe materiale ndërtimi.

Punëtorët dhe personeli i huaj do të kenë nevojë për strehim dhe ushqim. Është duke u përcaktuar përqindja e ushqimit ose furnizimeve për projektin që do të prokurohet nga kompanitë shqiptare, por duke supozuar vlerësime nga projekte të ngjashme mund të pritët që çdo krijim i vendeve të punës të rritet më së shumti në Korçë dhe në zonën përreth.

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Shuma e përgjithshme e krijimit të vendeve të punës që lidhen me prokurimin në nivel kombëtar pritet të jetë i vogël.

Grupet e ndjeshme në kontekstin e punësimit përfshijnë familjet e varfëra dhe të romëve; të parët për shkak të shkallës së ulët të përfundimit të shkollës dhe të fundit për shkak të përfundimit të shkollës së ulët, shkallës së ulët të shkrim-leximit dhe nganjëherë mungesës së gjuhës shqipe.

Prandaj, mund të konkludohet se projekti i propozuar do të ketë ndikim pozitiv të jetesës lokale. Ka gjithashtu përfitime për komunitetin më të gjerë nëpërmjet sigurimit të furnizimit me energji elektrike dhe ngrohjes shtëpiake për qytetin e Korçës.

Përdorimi i tokës ndikohet pozitivisht, pasi shërbimi i zgjeruar elektrik në zonë do të lulëzojë atë me aktivitete tregtare dhe një shumëllojshmëri të shërbimeve për komunitetin. Kjo bën që tokat e lira dhe të papërdorura të jenë të pasura me vlerë dhe të investohet në mënyra më të mira.

Çmimi i tokës do të ndikojë pozitivisht në zonat që aktualisht vuajnë nga mungesa e furnizimit me energji elektrike dhe si pasojë mund të priten aktivitete komerciale në rritje dhe shërbime më të mira komunale. Në përgjithësi, investime të mëtejshme vendore dhe të huaja në këtë zonë janë të mundshme.

Ndikimet e përkohshme ekonomike nga taksat dhe tarifat, prokurimet dhe shpenzimet e punëtorëve gjatë fazës së ndërtimit dhe fazës operacionale, duke përfshirë ndikimet ekonomike të pagesës së taksave.

6.2 Ndikimet e mundëshme negative

Përdorimi i tokës: Ka ndikim në përdorimin e tokës, pasi impianti do të jetë i vendosur në toka publike dhe private. Toka do të kompensohen duke u bazuar në vlerën e tregut, prandaj ndikime të tilla nuk mund të jenë të rëndësishme ose mund të klasifikohen si të vogla. Bazuar në informacionin paraprak mbi statusin e pronësisë së tokës, një total prej 90 ha tokë do të blihet nga pronarët privatë (90% e totalit) dhe nga shteti (10% i takon tokës publike).

Ndikimet e përdorimit të tokës mund të jenë të rëndësishme për shkak të aktiviteteve aktuale brenda gjurmës dhe tubacionit lidhës me një total prej 80 ha tokë të punueshme (kryesisht për bujqësi dhe kullotje). Një pjesë e parëndësishme e sipërfaqes totale të prekur (0.4%) është e regjistruar si zonë pyjore.

Megjithatë, kufizimi i aktiviteteve të ndërtimit në një korridor të ngushtë mund të zvogëlojë të tilla ndikime. Çdo kufizim në përdorimin e tokës do të nxjerrë në pah situatën ekonomike të familjeve të prekura, të cilat me gjasë nuk do të jenë në gjendje të gjejnë zona të tjera toke.

6.3 Siguria dhe shëndeti i komunitetit

Aksidentet mund të ndodhin kur lëvizin pajisjet dhe materialet e ndërtimit në zonën e projektit. Përveç kësaj, njerëzit e komunitetit mund të hyjnë në të. Megjithatë, kjo është

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

shumë e vështirë pasi zona e projektit do të rrethohet si dhe projekti do të ndjekë rregulla strikte të trafikut. Sidoqoftë, shkarkimet, pluhuri dhe tymi mund të kenë një ndikim të rëndësishëm për banorët e komunitetit në afërsi të zonës së projektit.

Figura 6: Harta e parcelave të prekuara


Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces



Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces



Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

7. Ndikimet Mjedisore të Projektit

7.1 Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit në mjedis

Ndikimet potenciale mjedisore që krijohen nga ndërtimi i TEC-it të Korçës janë analizuar për fazën e ndërtimit dhe të operimit të projektit. Kjo përfshin ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta dhe gjithashtu merr në konsideratë ndikimet kumulative. Ndikimet mjedisore përfshijnë emetimet dhe rrjedhimisht cilësinë e ajrit të ambientit; tokës dhe ujërave nëntokësore; tokës; ujërat sipërfaqësorë dhe ujërat nëntokësorë; florën dhe faunën e vendit dhe në afërsitë e tij; ekosistemi ujor i kanaleve ngjitur; mbeturinat dhe depozitimi i tyre; zhurma dhe shqetësime të tjera; trafiku; dhe ndikimet sociale. Ndikimet mjedisore kryesore që janë identifikuar gjatë studimit janë nënvizuar më poshtë:

7.2 Ndikimet në burimet e ujit

Projekti është shumë efikas në përdorimin e ujit. Kërkesa për ujë teknologjik për procesin e ftohjes do të jetë 12.5 m³/orë (sipas projektit) dhe 4 m³/orë. Burimi kryesor për sigurimin e ujit teknologjik do të jetë impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Korçë që ndodhet pranë vendndodhjes TEC-it dhe dy puseve shtesë që do të përdoren vetëm në rast emergjence. Vetëm nevojat për ujë të pijshëm do të sigurohet nga rrjeti i furnizimit me ujë të qytetit të Korçës.

Kërkesat për ujë (për kullat e ftohjes dhe sistemin e ftohjes së mbyllur), si dhe kërkesa për ujë për të gjitha proceset e tjera gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të propozuar do të sigurohen nga uji i trajtuar nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura si dhe përdorimi i ujërave nëntokësore si burim rezervë uji (vetëm në rast emergjence do të nxjerr ujë nga dy puset në zonë). Kapaciteti i puseve do të jetë ca. 20-30 l/s secili.

Kapaciteti total i impiantit të ujërave të ndotura në 2016 ishte 4,407,813 m³ dhe një mesatare mujore prej 139 l/s.

Muaji	Temperatura ° C
Janar	9.6
Shkurt	10
Mars	12.2
Prill	15
Maj	15.9
Qershor	21.4
Korrik	21.9
Gusht	22.8
Shtator	19.9

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

Tetor	14.5
Nëntor	12.6
Dhjetor	10.7

Cilësia e ujit pas trajtimit:

Parametrat	PERIUDHA E VERËS (vlera mesatare)	PERIUDHA E DIMIRIT (vlera mesatare)
përcjellshmëria	1152.2 μ S/cm	1121.4 μ S/cm
PH	7,82	7,972
BOD	23.4 mg/l	21.4 mg/l
COD	117.2 mg/l	91.75 mg/l
TN	515.5 kg/m3ditë	731 kg/m3ditë
TP	60 kg/m3ditë	98 kg/m3ditë

Kërkesa totale për ujit për ftohje gjatë verës nevojitet të jetë në kufirin e 30°C dhe lagështia Relative (RH) 50% do të jetë 460 m3/orë (128 l/s). Pas procesit të ftohjes në lumin pranë do të shkarkohet rreth 20% e përbërjes totale të ujit për ftohje, dhe do të jetë rreth 25 l/s. Temperatura e ujit të shkarkuar do të varet nga temperatura atmosferike dhe do të jetë më e lartë për rreth 10°C. Uji pastaj do të përpunohet në impiantin e trajtimit të ujit për të përmbushur kërkesat e ndryshme të impiantit.

Mesatarja e të dhënave të projektit të propozuar nga zhvilluesi (jo maksimale) prej 17-18 °C në hyrjen e kondensatorit (për të marrë presionin në kondensator rreth 0.06 bar). Temperaturat e larta të hyrjes së ujit nënkuptojnë një presion më të lartë në kondensator, dhe për këtë arsye, efikasitet më të ulët të procesit.

Duke qenë një aquifer me rëndësi rajonale që mbulon pjesën më të madhe të fushës së Korçës, pusët në këtë zonë kanë kapacitet specifik të mesëm dhe cilësia e ujit në përgjithësi konsiderohet e mirë, edhe pse janë zbuluar hekuri, nitratet dhe nitritet në ujërat nëntokësore. Duke pasur parasysh nevojën e kufizuar të ujërave nëntokësore si burim rezervë, normalisht nuk do të ketë ndikime ose këto ndikime do të jenë të vogla për shkak të nxjerrjes së ujërave nëntokësore vetëm kur do të kërkohet ujë nëntokësor rezervë.

Përdorimi i ujërave të ndotura të trajtuara nga impiantet komunale të trajtimit të ujërave të ndotura për kondensatorin e sistemit të ftohjes nuk pritet të çojë në një rritje të temperaturës në trupin ujqor pritës, në përputhje me kufijtë ligjorë.

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

7.3 Zhurma dhe dridhjet

Në të gjitha zonat ku komponentët e sistemit të TEC-it që do të instalohet, dhe ku personeli mund të jetë i pranishëm për operime rutine ose aktivitete të mirëmbajtjes, niveli i përgjithshëm i zhurmës nuk do të kalojë limitet e mëposhtme:

- Niveli i integruar i presionit akustik sipas standardit ISO do të jetë maksimumi 85 dB (A) në 1 m nga burimi kryesor i zhurmës, ose nga strukturat e tyre akustike nëse ofrohen.

Gjatë aktiviteteve të para ndërtimit dhe ndërtimit, ka mundësi të shkaktohet zhurmë për shkak të përdorimit të makinerive të rënda, elektromotorëve dhe gjeneratorëve dhe për shkak të trafikut të rëndë. Automjetet e përdorura për transportin e forcës puntore dhe materialeve në vend do të gjenerojnë zhurmë përgjatë rrugës të përdorura. Ndikimi i saktë nuk mund të parashikohet. Megjithatë, mospërputhja me limitin ligjor¹ mund të zbutet me masa të përshtatshme si shmangia e aktiviteteve të zhurmshme gjatë kohës së natës dhe ndërtimi i barrierave të zhurmës. Pajisja do të duhet të jetë në përputhje me ligjin kombëtar për të kufizuar zhurmën në vend në 85 dB në një metër distancë nga pajisjet për gjenerimin e zhurmave dhe të përputhet për të kufizuar ekspozimin ndaj zhurmës jashtë zonës deri në 65 dB gjatë ditës dhe 55 dB gjatë natës - koha në kufijtë e termocentralit².

Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Mjedisit, dhe Ministri i Shëndetësisë Nr. 8, datë 27.11.2007 "Për të kufizuar nivelet e zhurmës në zona të caktuara", përcakton vlerat kufi të zhurmës, vlerat që drejtojnë Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh).

Tabla 8: Kufizimet e niveleve të zhurmave për mjedise të veçanta

Mjedisi	Efekti kritik shëndetësor	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	LAmaks Shpejtë (dB)
Zona me aktivitete socio-ekonomike				
Fushat industriale, komerciale dhe trafiku (mjedisi i jashtëm dhe i	Dëmtimi i dëgjimit	70	24	110

² Rekomandimi i BE për hartimin e zhurmës (Direktiva 2002/49 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 qershorit 2002 në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës së mjedisit - Deklarata nga Komisioni në Komitetin e Pajtimit për Direktivën në lidhje me vlerësimin dhe Menaxhimin e zhurmave mjedisore)

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

brendshëm)				
Mjedisi urban				
Mjediset publike, mjedisi i jashtëm ose i brendshëm	Dëmtimi i dëgjimit	85	1	110

Shpjegime:

LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në një shkallë A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës është matur.

Shpejt LAmax (dB) = Niveli i matur në një shkallë A por në një mënyrë të shpejtë (Shpejtë)

LAmax, shpejt= Presioni maksimal i zërit i matur 100 mm nga veshi

Nëse jemi në gjendje të vlerësojmë emetimet bazuar në teknologjinë e përzgjedhur, mund të jetë e dobishme të vlerësojmë ndikimet e zhurmës gjatë fazës së operimit dhe ti krahasojmë me nivelet e lejuara dhe gjendjes ekzistuese. Kjo do të jetë e dobishme për të zgjedhur teknologjinë e duhur dhe masat e zbutjes nëse ka shqetësime. Përveç kësaj, për studimin e plotë të VNM-së duhet të kryhet një studim i matjes së zhurmës për receptorët e mundshëm brenda një zone me rreze prej 1 km.

Bazuar në diskutimet e mësipërme, ndikimi i zhurmës vlerësohet si efekte të moderuara, me kohëzgjatje afatmesme dhe vlerësohet me ndikim të mesëm.

7.4 Emetimet dhe shkarkimet

Kapitulli i mëparshëm mbi kushtet bazë siguroi informacionin e disponueshëm për cilësinë e ajrit të ambientit në zonën e projektit. Për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet në cilësinë së ajrit ne duhet të parashikojmë dhe vlerësojmë emetimet si kontribut i projektit (punimet e ndërtimit dhe operimi i impiantit) në cilësinë e ajrit. Këtu përfshihen të gjithë parametrat përkatës: lënda e grimcuar, monoksidi i karbonit dhe dioksidi i karbonit, oksidet e azotit dhe dioksidi i squfurit. Për shkak të karburantit të përdorur dhe efikasitetit të lartë të njësive të reja, emetimet relative janë përgjithësisht më të ulëta se sa për njësitë që përdorin naftë të rëndë.

Burimet e shkarkimeve të ajrit gjatë fazës së ndërtimit do të përfshijnë pajisje të ndryshme ndërtimi, njësi gjeneratoreshtë gatshëm dhe automjete. Ndotësit kryesorë të lëshuar nga burime të tilla përfshijnë NOX, SO2, CO, PM10 dhe hidrokarbure të padjegura.

Burimet kryesore të ndikimeve të mundshme në cilësinë e ajrit të ambientit gjatë fazës së ndërtimit të projektit të propozuar janë paraqitur më poshtë:

Kompania: ABKONS

Titulli i Dokumentit: Vlerësimi Strategjik, Social, Mjedisor & Ekonomik – Termocentrali i Korces

- Gjenerimi i pluhurit për shkak të përgatitjes së lokacionit, punimeve në tokë, gërmimeve dhe lëvizjes së automjeteve;
- Cilirimit të SO_2 , NO_x , VOC dhe PM_{10} nga motorët me naftë të makinerive dhe automjeteve të ndërtimit, dhe gjeneratorë të gatshëm të përdorur për prodhimin e energjisë;
- Lirimi i tymit të saldimit dhe Përbërjet Organike të Avulluara (VOC) nga saldimi / punimet e fabrikimit të metaleve, pastrimi i sipërfaqes dhe piktura;
- Emetimet e liruara nga magazinimi i lëndëve djegëse, vajrave lubrifikues dhe kimikateve të tjera që lirojnë VOC.

Gjatë fazës së operimit, shkarkimet në ajrit do të jenë kryesisht nga burimet pikash stacionare, burimet e lëvizshme dhe burimet fugjitive të emetimeve. Burimet e pikave do të përfshijnë stogun e bashkangjitur me Gjeneratorët dhe njësitë HRSG. Burimet e emetimeve fugjitive përfshijnë depozitat, valvolat, fillanxhat dhe pajisje tubo. Burimet e levishme përfshijnë automjetet e përdorura për transportin e punëtorëve dhe të materialeve. Ndotësit kryesorë të lëshuar nga burime të tilla përfshijnë NO_x , SO_2 , CO, PM_{10} , UHC dhe Përbërjet Organike të Avulluara (VOCs).

Do të ketë një rritje të vogël në emetimet atmosferike, por brenda kufijve dhe udhëzimeve përkatëse. Ndikimi i TEC-it në cilësinë e ajrit do të vlerësohet në tri nivele:

- në nivel lokal, ku ndikimi mund të vlerësohet nga modeli matematikor i cili përcakton lidhjen ndërmjet emetimeve dhe përqendrimeve tokësore;
- në nivel rajonal dhe global: vlerësimi do të bëhet duke u bazuar në sasitë e emetimeve, njohjen e cilësisë së mjedisit rajonal dhe treguesve të cilësisë së operimit të objektit.

Diskutimi mbi ndotësit kryesorë të ajrit:

- Emetimi i SO_x : Nuk do të ketë ndotje në ajër dioksidi i squfurit nga TEC, sepse do të djegë gazin, si karburanti i vetëm është i lirë nga squfuri.
- Emetimi i NO_x : Turbina e gazit do të pajiset me dhoma për djegieje NO_x të ulët, që kanë provuar se sigurojnë emetim të NO_x në përputhje me standarde ndërkombëtare të rrepta.
- Emetimi i grimcave: Përdorimi i gazit si lëndë djegëse, praktikisht eliminon emetimin e grimcave. Si rrjedhojë, operimi i strukturës nuk duhet të kufizohet.
